



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 175

Tiranë – E premte, 20 dhjetor 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11380, datë 10.12.2019	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 13267
Dekret i Presidentit nr. 11388, datë 16.12.2019	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 13267
Dekret i Presidentit nr. 11389, datë 18.12.2019	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 13268
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 26, datë 25.11.2019	Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar.. 13268
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 27, datë 26.11.2019	Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2020..... 13270
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 28, datë 12.12.2019	Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve kombëtare të Maturës Shtetërore 2020..... 13272
Urdhër i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 580, datë 13.12.2019	Për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor jopublik të nivelit të arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë, “Drita e Diturisë”, Tiranë..... 13273
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 17996, datë 17.12.2019	Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje ndërkombëtare..... 13274

Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 6345/7, datë 18.12.2019	Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të llojit tokë, truall dhe ndërtesë jo banimi, që preken nga realizimi i projektit “Studim-projektim i <i>By-Pass</i> Tepelenë, loti 1”	13274
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 6489/7, datë 18.12.2019	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preket nga projekti, “Rikonstruksion i rrugës ‘Dhimitër Shuteriqi’”, në Tiranë.....	13276
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 10632, datë 18.12.2019	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Ndërtimi i segmentit rrugor Unaza Lindore, loti 3”, Tiranë.....	13280

**DEKRET**

Nr. 11380, datë 10.12.2019

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe nenit 9, e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, me propozim edhe të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Bariş Kenan Akin
2. Ayşe Cuma Kaya (Duman)
3. Ali Idris Salih Bilen
4. Jeronim Palush Pnishi
5. Devrim Hayri Gülsuna
6. Ganija Sejdi Demolli
7. Raya Yarob Rayyan (Rayyan)
8. Aljona Alija Jonuzi (Aliajdara)
9. Mehtap Cemil Demircin (Sucuk)
10. Mustafa Mehmet Kirli
11. Ioana-Cristina Ioan Mitescu
12. Martin Fritz Lerch
13. Dilek Basri Iliri (Demirkaya)
14. Qemajl Axhi Duraku
15. Qendresa Zaim Vezaj (Bajraktari)
16. Özlem Ahmet San (Türk)
17. Frrok Engjell Perdedaj
18. Raia Hassan Raian
19. Arlinda Amrush Jashanica (Morina)
20. Shpresa Tafo Upe (Vuçinaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

DEKRET

Nr. 11388, datë 16.12.2019

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Arjola Enver Llangozi
2. Ledian Edmond Miha
3. Hermela Fehmi Karruku (Kusi)
4. Nexhmije Isuf Çakraj (Hasandoçaj)
5. Danilo Pirro Matanoviq (Matanović)
6. Suzana Martin Pjetra (Qehaja)
7. Patrik Flamur Shamo
8. Erind Llazar Gjermani
9. Le Duc Nadia Erind Gjermani
10. Jurik Apolon Baçe (Bace)
11. Albi Bledar Kuçi
12. Mirsela Menduh Kthupi
13. Venera Sulejman Wind (Çoçoli)
14. Ervisa Novrus Goduni
15. Arijona Vebi Berisha
16. Emma Vebi Berisha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

**DEKRET**

Nr. 11389, datë 18.12.2019

**PËR DHËNIE TË SHKETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Latif Haziz Ramadani
2. Selvete Ilaz Ramadani (Shabani)
3. Dardane Milazim Ramadani (Hoxhaj)
4. Gazmend Latif Ramadani
5. Armend Latif Ramadani
6. Valbone Gjon Hajdari
7. Enver Jusuf Hoti
8. Leona Faton Krasniqi
9. Adem Azem Grabovci
10. Kumrije Miftar Grabovci Agaj (Agaj)
11. Guxim Adem Grabovci
12. Ngadhnjim Adem Grabovci
13. Lulzim Isen Kabashi
14. Visare Syla Kabashi (Millaku)
15. Diar Lulzim Kabashi
16. Urtesa Lulzim Kabashi
17. Ujana Lulzim Kabashi
18. Jetmir Isen Kabashi
19. Kushtrim Fadil Hasani
20. Ruzhdi Avdyli Kurtishaj
21. Aleksandra Vladimir Tarasenko
22. Yavor Slavcho (Slavchev) Valchev
23. Vladislav (Vlatislav) Vladimir Tkachenko (Tkachenko/Tkaçenko)
24. Lum Anton Berishaj
25. Ledri Agron Vula
26. Maria Vjacheslav Pacolli (Shichkova)
27. Arben Hisen Dauti
28. Xhevat Xhemal Latifi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

UDHËZIM

Nr. 26, datë 25.11.2019

**PËR MËSUESIN NDIHMËS PËR
NXËNËSIT ME AFTËSI TË KUFIZUARA
NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË
ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 65/3, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:**KREU I****KRITERET DHE PROCEDURAT E
PËRZGJEDHJES SË MËSUESIT NDIHMËS**

1. Mësuesi ndihmës, për nxënësit me aftësi të kufizuara (AK) në institucionet arsimore publike, duhet të plotësojë këto kriterë:

a) të jetë i pajisur me licencë mësuesi në profilin “Arsim special”;

b) kur nuk ka mësues të profilit “Arsim special”, të jetë i pajisur me diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit, konform kërkesave të nenit 57, pika 2, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të ketë kryer trajnime për arsimimin e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe të jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi/diplomë që vërteton këtë kompetencë profesionale të shtuar.

2. Procedurat e përzgjedhjes së mësuesit ndihmës janë në përputhje me udhëzimin për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”.

3. Norma mësimore javore e mësuesit ndihmës dhe qëndrimi fizik në institucionin arsimor është i njëjtë me atë të mësuesit të zakonshëm në klasë, sipas udhëzimit për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar.

4. Një mësues ndihmës mund të punojë me 2 deri në 3 nxënës me aftësi të kufizuara brenda të njëjtit institucion arsimor, sipas rekomandimit të Komisionit Multidisiplinar të ngritur pranë Zyrës



Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP-ve), bazuar në nivelin e vështirësisë dhe të nevojës për mbështetje që paraqet nxënësi.

5. Në një klasë ku ka më shumë se një nxënës me AK nuk mund të punojë më shumë se një mësues ndihmës.

6. Komisioni Multidisiplinar i ngritur pranë ZVAP-ve, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur për çdo nxënës nga prindi/kujdestari ligjor apo nga institucioni arsimor, vlerëson shkallën e vështirësisë së nxënësit dhe përcakton:

- a) nevojat arsimore të nxënësit;
- b) nevojën për mësues ndihmës në klasë;
- c) nevojën për mësues ndihmës në shtëpi;
- ç) numrin e orëve mësimore të nevojshme për çdo nxënës me AK dhe e shënon atë në dosjen e vlerësimit;
- d) pas çdo vlerësimi (një herë në vit) bën rivlerësim të nevojës së nxënësit për mësues ndihmës.

7. Bazuar në këtë vlerësim dhe në pikën 5 dhe shkronjën “d”, të pikës 6 të këtij udhëzimi, drejtori i shkollës, në bashkëpunim me komisionin e shkollës, përcakton numrin e orëve që një mësues ndihmës do të ketë për çdo fëmijë me AK, brenda klasës ose në shtëpi.

KREU II

DETYRAT E MËSUESIT NDIHMËS

1. Mësuesi ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara ka këto detyra kryesore:

a) punon për zhvillimin e plotë të potencialit intelektual, socioemocional, zhvillimor e fizik të nxënësit;

b) njeh dhe zbaton pedagogjinë me në qendër nxënësin dhe ndihmon në krijimin e mjedisit gjithëpërfshirës të të nxënësit;

c) në bashkëpunim me mësuesin e klasës/mësuesin lëndor, psikologun, punonjësin social të shkollës dhe prindin, harton dhe zbaton programin edukativ individual (PEI), të miratuar nga komisioni i shkollës për nxënësit me AK;

ç) në bashkëpunim me mësuesin e klasës/mësuesin lëndor planifikon ndërhyrjet për të plotësuar nevojat më prioritare të të nxënësit për nxënësin;

d) bashkëpunon me mësuesin e lëndës dhe me shërbimin psikosocial të institucionit arsimor për

vlerësimin e nxënësit, sipas nivelit të arritjeve të fushave të zhvillimit të përcaktuara në PEI;

dh) asiston nxënësin gjatë procesit mësimor, si brenda, ashtu dhe jashtë klasës, për të bërë të mundur pjesëmarrjen e tij/saj sa më të plotë në të gjitha orët mësimore dhe në aktivitetet shkollore;

e) në ato shkolla ku ekzistojnë hapësira zhvillimore, shfrytëzon mundësitë për të zbatuar program kurrikular alternativ në përputhje me PEI-n e nxënësit;

ë) punon në bashkëpunim me psikologun e shkollës, punonjësin social ose stafin e specializuar për zhvillimin të nxënësi të aftësive sociale, emocionale, zhvillimore dhe aftësive të tjera për jetën, duke nxitur dhe stimuluar kalimin e nxënësit nga varësia në pavarësi;

f) ndjek dhe dokumenton aspektet e ecurisë, si dhe ruan e respekton konfidencialitetin e informacionit për nxënësin, sipas ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar;

g) punon me nxënësit me AK krahas mësuesit në të gjitha orët mësimore apo në një pjesë të tyre, gjithashtu jashtë klasës, me nxënës të veçantë me AK ose me grupe të vogla të klasave I–III, IV–V, VI–IX dhe X–XII, bazuar në rekomandimin e komisionit multidisiplinar të ZVAP-së, sipas një orari të miratuar nga drejtoria e shkollës;

gj) ndjek trajnimet e ofruara për zhvillimin e tij profesional me parimet e arsimit gjithëpërfshirës dhe arsimit special;

h) raporton në komisionin e shkollës mbi ecurinë e fëmijës dhe realizimin e PEI-t.

2. Mësuesi ndihmës informon prindërit /kujdestarët ligjorë për progresin mësimor dhe zhvillimor të nxënësit në takime të përcaktuara nga drejtoria e shkollës.

3. Mësuesit dhe mësuesi ndihmës bashkëpunojnë me prindërit, në mënyrë që veprimtaritë që zhvillohen dhe njohuritë e marra në institucionin arsimor dhe në shtëpi, të plotësojnë dhe të përforcojnë njëra-tjetrën.

4. Mësuesi ndihmës, mësuesi kujdestar, shërbimi psikosocial i institucionit arsimor informon prindërit/kujdestarët ligjorë të nxënësit me AK për shërbime të specializuara për të cilat ka nevojë nxënësi, të cilat ofrohen në shkollë ose në zonë.

5. Në ato zona ku ekzistojnë shërbime lëvizëse të operatorëve socialë të asistencës shtëpiake për fëmijët me AK, që nuk aksesojnë dot një



institucion arsimor, mësuesi ndihmës bashkërendon punën për të ofruar shërbimin së bashku me ekipin lëvizës të asistencës shtëpiake.

KREU III DISPOZITAT E FUNDIT

1. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

2. Udhëzimi nr. 38, datë 7.10.2014, “Për kriteret e mësuesit ndihmës për nxënësit më aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

UDHËZIM Nr. 27, datë 26.11.2019

PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2020

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 26 dhe 51, të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 7, germa “dh” dhe të nenit 8, germa “b”, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJMË:

1. Provimet e Maturës Shtetërore Profesionale 2020, për shkollat e mesme profesionale, të jenë:

- Provime të detyruara: gjuhë shqipe dhe letërsi, matematikë, gjuhë e huaj dhe teori profesionale e integruar, sipas drejtimit/profilin që maturanti /kandidati ka ndjekur në shkollë.

2. Lëndët dhe datat për provimet e Maturës Shtetërore Profesionale 2020, të jenë:

- a) gjuhë e huaj 8 qershor 2020
- b) gjuhë shqipe dhe letërsi 11 qershor 2020
- c) matematikë 15 qershor 2020
- d) teori profesionale e integruar 18 qershor 2020

3. Administrimi i provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2020 bazohet në Rregulloren e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë.

4. Testi i gjuhës së huaj (D3) hartohet në përputhje me gjuhën e cila në planin mësimor të arsimit të mesëm profesional trajtohet si gjuhë e huaj e parë. Testi i provimit të jetë në nivelin gjuhësor që përcaktohet në kurrikul në përfundim të arsimit të mesëm profesional.

5. Gjuha e huaj, si provim i detyruar, përzgjidhet gjatë plotësimit të formularit A1/A1Z. Kandidatët e viteve të kaluara (të maturave shtetërore 2014, 2015, 2016, 2017, 2018 dhe 2019) që kanë rezultuar jokalue në provimin D3, duhet ta rijapin këtë provim. Kandidatët e tjerë (të maturave shtetërore para vitit 2014) që aplikojnë me A1Z, nuk do ta rijapin provimin e detyruar D3.

6. Lista e provimit të detyruar të teorisë profesionale të integruar sipas drejtimit/profilin që maturantët/kandidatët kanë ndjekur në shkollat profesionale:

Nr.	Drejtimi/profili profesional
1	Hoteleri-turizëm
2	Shërbime mjetesh transporti
3	Mekanikë
4	Elektroteknikë
5	Elektronikë
6	Përpunim druri
7	Ndërtim
8	Tekstil-konfeksione
9	Tekstil-konfeksione (NABER ADA)
10	Teknologji ushqimore
11	Bujqësi
12	Shërbime sociale dhe shëndetësore
13	Instalues i sistemeve termohidraulike
14	Teknologji kimike
15	Peshkim



16	Detari
17	Gjeologji-miniera
18	Llogari
19	Shërbime bankare
20	Sipërmarrje e agjencisë turistike
21	Sigurime
22	Tregti
23	Administrim biznesi
24	Rrjete të dhënash
25	Mbështetje e përdoruesve të TIK-ut
26	Zhvillim <i>website</i> -i
27	Rrjete të dhënash (pilot-giz)
28	Inxhinieri informatike <i>software</i> -sh (<i>Hermann Gmeiner</i>)
29	Silvikulturë
30	Agrobiznes
31	Veterinari
32	Gjeodezi
33	Biznes (<i>Harry Fultz</i>)
34	Elektronikë (<i>Harry Fultz</i>)
35	Automekanik (<i>Harry Fultz</i>)
36	Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji
37	Shërbime kujdesi për të moshuar (pilot GIZ)

7. Provimet e detyruara gjuhë shqipe dhe letërsi, matematikë, gjuhë e huaj e parë dhe programet orientuese të tyre, të mbështeten në programet ekzistuese të kulturës së përgjithshme të arsimit profesional.

8. Provimet e detyruara të teorisë profesionale të integruar, sipas tabelës në pikën 6, të mbështeten në programet orientuese të publikuara në faqen e Agjencisë Kombëtare të Arsimit Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.

9. Kandidati, i cili rezulton mbetës në të paktën njërin prej provimeve të detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale, duhet ta rijapë atë që të pajiset me diplomë.

10. Kandidati që në Maturën Shtetërore 2013–2016:

a) ka zgjedhur teorinë profesionale të integruar dhe është kalues, të pajiset me diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, pavarësisht se mund të rezultojë jokalue në një apo dy provimet e tjera me zgjedhje.

b) ka zgjedhur teorinë profesionale të integruar dhe rezulton mbetës, duhet të rijapë provimin e

detyruar të teorisë profesionale të integruar, pavarësisht rezultateve të provimeve të tjera me zgjedhje.

c) ka zgjedhur dy apo tri lëndë me zgjedhje, të cilat nuk përfshihet Teoria profesionale e integruar, duhet të japë provimin e detyruar të teorisë profesionale të integruar, pavarësisht rezultateve të provimeve të tjera me zgjedhje.

11. Kandidatët që kanë marrë dëftesë pjekurie para vitit 2011 dhe dëshirojnë të aplikojnë për studime në institucionet e arsimit të lartë, t'u njihen provimet e detyruara ose provimet e njëvleftshme me to, të njësuara nga njësitë arsimore vendore. Këta kandidatë, në rastet kur nuk ka dhënë provimin e Teorisë profesionale të integruar ose e kanë dhënë dhe nuk kanë rezultuar kalues, kanë të drejtë të japin këtë provim, kur e kanë të nevojshme për plotësimin e kriterëve të pranimit të përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë.

12. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, zëvendësministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, zëvendësministri i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Sekretari i Përgjithshëm i MASR-së, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

MINISTËR I FINANCIVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj



UDHËZIM

Nr. 28, datë 12.12.2019

**PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN
E PROVIMEVE KOMBËTARE
TË MATURËS SHTETËRORE 2020**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 26 dhe 51, të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Lëndët e provimeve të Maturës Shtetërore 2020, për arsimin e mesëm të lartë, të jenë:

- a) provime të detyruara: gjuhë shqipe dhe letërsi, matematikë dhe gjuhë e huaj;
- b) një provim me zgjedhje.

1.1 Testi i gjuhës së huaj (D3) hartohet në përputhje me gjuhën e cila në planin mësimor të arsimit të mesëm të lartë trajtohet si gjuhë e huaj e parë. Testi i provimit të jetë në nivelin gjuhësor që përcaktohet në kurrikul në përfundim të arsimit të mesëm të lartë.

1.2 Lista e gjuhëve të huaja, që jepen si provim i detyruar (D3) është: anglisht, frëngjisht, italisht dhe gjermanisht. Gjuha e huaj si provim i detyruar përzgjidhet gjatë plotësimit të formularit A1/A1Z.

2. Provimi me zgjedhje

2.1 Lista e lëndëve të provimit me zgjedhje të jetë:

Kimi;
Fizikë;
Biologji;
Histori;
Gjeografi;
Qytetari dhe psikologji;
Filozofi dhe sociologji;
Ekonomi;
Histori arti;
Histori muzike;
Histori baleti.

2.2 Provimet e detyruara të mbështeten vetëm në kurrikulën bërthamë. Programet orientuese të provimeve të detyruara (gjuhë shqipe dhe letërsi, matematikë, gjuhë e huaj) për të gjithë maturantët/kandidatët të jenë në përshtatje me programet ekzistuese të arsimit të mesëm të lartë.

2.3 Programet orientuese të lëndëve me zgjedhje të jenë të njëjta për të gjithë maturantët/kandidatët që plotësojnë formularin A1/A1Z.

2.4 Programi orientues i lëndëve me zgjedhje përmban programin e lëndës bërthamë dhe atë me zgjedhje.

2.5. Maturanti/kandidati zgjedh një lëndë nga lista e lëndëve me zgjedhje, pavarësisht nëse i ka zhvilluar ose jo apo i janë ofruar ose jo ato nga shkolla në programin mësimor.

3. Kandidatit, që ka dhënë dy ose më shumë provime me zgjedhje dhe është vlerësuar me notë të përshkallëzuar jo më të vogël se 4.50 (nota 5), i njihen ato provime dhe nuk mund t'i japë më.

4. Kandidatët, të cilët rezultojnë mbetës në të paktën njërin prej provimeve të Maturës Shtetërore, duhet ta rijapin atë që të pajisen me diplomë.

5. Kandidatët, që në Maturat Shtetërore 2012–2019 nuk kanë rezultuar kalues në asnjë prej provimeve që kanë zgjedhur për të dhënë, japin vetëm një lëndë nga lista e lëndëve me zgjedhje të këtij udhëzimi.

6. Datat, për provimet e Maturës Shtetërore 2020, të jenë:

- a) gjuhë e huaj 8 qershor 2020;
- b) gjuhë shqipe dhe letërsi 11 qershor 2020;
- c) matematikë 15 qershor 2020;
- d) provimi me zgjedhje 18 qershor 2020.

7. Administrimi i provimeve të Maturës Shtetërore 2020 bazohet në Rregulloren e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë.

8. Provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2020 fillojnë në orën 10:00 dhe zgjasin 2 orë e 30 minuta.

9. Testet e provimeve të detyruara dhe të provimit me zgjedhje hartohen, administrohen dhe vlerësohen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA).

10. Testi për secilin nga provimet e detyruara dhe të provimit me zgjedhje vlerësohet me 60 pikë maksimale.

11. Maturantët/kandidatët që rezultojnë mbetës në provimet e Maturës Shtetërore 2020, i rijapin provimet në sesionin e dytë.

12. Zyrat vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP), pasi marrin nga institucionet e arsimit të mesëm të lartë listat e maturantëve mbetës të vitit shkollor 2019–2020 i pasqyrojnë ato në portalin e



Maturës Shtetërore *online*, sipas udhëzimit dhe kalendarit të përcaktuar nga QSHA-ja. Këto lista dërgohen në QSHA, në format të printuar dhe elektronik.

13. Institucionet e arsimit të mesëm të lartë të organizojnë konsultimet në ndihmë të nxënësve maturantë për provimet e Maturës Shtetërore, sipas një kalendarit të miratuar nga ZVAP-ja. Këto konsultime do të jenë objekt monitorimi nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar.

14. Testi i provimit “Gjuhë dhe letërsi italiane” (*Lingua e literatura italiana*), për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane, përgatitet nga Ministria e Arsimit e Republikës së Italisë dhe provimi zhvillohet në datën 25 maj 2020, në shkollat përkatëse.

15. Testi i provimit “Gjuhë frënge” (*DEL F B2 scolaire*), për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-franceze përgatitet nga Ambasada Franceze dhe provimi zhvillohet në datën 25 maj 2020, në shkollat përkatëse.

16. Tërheqja e testeve të provimeve kombëtare të Maturës Shtetërore 2020 bëhet sipas grafikut të hartuar nga QSHA-ja dhe të miratuar nga Komiteti i Maturës Shtetërore 2020.

17. Provimet kombëtare të Maturës Shtetërore 2020 zhvillohen në qendrat e provimeve të përcaktuara nga Komisioni i Maturës Shtetërore në ZVAP, mbështetur në Rregulloren e Maturës Shtetërore.

18. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, zyrtat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

URDHËR

Nr. 580, datë 13.12.2019

PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR JOPUBLIK TË NIVELIT TË ARSIMIT BAZË DHE TË ARSIMIT TË MESËM TË LARTË, “DRITA E DITURISË”, TIRANË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikave 3 dhe 7 të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të vendimit nr. 505, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”, dhe të udhëzimit nr. 15, datë 12.7.2013, “Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor jopublik të nivelit të arsimit bazë dhe të nivelit të arsimit të mesëm të lartë, “Drita e Diturisë”, Tiranë, licencuar me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, nr. 295, datë 5.10.2000, “Për dhënie leje funksionimi të institucionit arsimor jopublik” dhe me urdhër nr. 48, datë 2.3.2001, “Për dhënie leje funksionimi të institucionit arsimor jopublik”.

2. Subjekti “Drita e Diturisë” sh.p.k., me administratore znj. Pranvera Hackaj, e cila ka administruar institucionin arsimor jopublik “Drita e Diturisë”, Tiranë, ka këto detyrime:

a) Të vendosë në dispozicion të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë, çdo informacion të kërkuar.

b) Subjekti “Drita e Diturisë” sh.p.k., me administratore znj. Pranvera Hackaj, të depozitojë menjëherë, pranë Arkivit Shtetëror Vendor Tiranë, të gjithë dokumentacionin e shkollës, sipas ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”.

3. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë ka për detyrë të monitorojë procesin e dorëzimit të dokumentacionit nga subjekti “Drita e Diturisë” sh.p.k. dhe të raportojë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.



4. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet e saj të varësisë të njohin veprimtarinë e kryer dhe dokumentacionin e lëshuar nga institucioni arsimor jopublik “Drita e Diturisë”, deri në datën 16.9.2017.

5. Urdhrat e ministrit përgjegjës për arsimin, me nr. 295, datë 5.10.2000, “Për dhënie leje funksionimi të institucionit arsimor jopublik” dhe nr. 48, datë 2.3.2001, “Për dhënie leje funksionimi të institucionit arsimor jopublik”, shfuqizohen.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në MASR, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Durrës, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe subjekti, “Drita e Diturisë” sh.p.k., Tiranë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

NJOFTIM
Nr. 17996, datë 17.12.2019

MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË MARRËVESHJEJE KOMBËTARE

“Marrëveshja me shkëmbim notash ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Stabilizim-Asociimit, Bashkimi Evropian-Shqipëri, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë, me cilësinë e vëzhguesit në punën e Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore dhe mënyrën e kësaj pjesëmarrjeje në kuadrin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 168/2007”, hyn në fuqi më 1 janar 2020.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

KËRKESË

Nr. 6345/7, datë 18.12.2019

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, shpall kërkesën për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të llojit tokë, truall dhe ndërtesë jo banimi, që preken nga realizimi i projektit “Studim-projektim i *By-Pass* Tepelenë, loti 1”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private (sipas tabelës bashkëlidhur), të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur në bazë të VKM-së nr. 89, datë 3.6.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, si dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit dhe marrjes në përdorim të përkohshëm. Lutemi pronarëve dhe personave që pretendojnë pronësinë mbi pasuritë që preken nga ky projekt, të dorëzojnë çdo dokument që disponojnë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tepelenë, mbi saktësimin dhe konfirmimin e pronësisë, sipërfaqeve, mungesat e dokumentacionit etj.

- Vlera totale e shpronësimit është 23,946,990.99 (njëzet e tre milionë e nëntëqind e dyzetë e gjashtë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë pikë nëntëdhjetë e nëntë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR
I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli



LISTA E PASURIVE QE SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
“STUDIM-PROJEKTIM I BY-PASS TEPELENË, LOTI 1”

Nr.	Pronari			Të dhënat (mbi pasurinë sipas ZVRPP-së)									Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K.	Nr. pas.	Lloji pas.	Sip. totale (m²)	Shpronësim tokë “truall”			Ndërtesë jo banimi			
								Sip. (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sip. nd. konf. nga ZVRPP-ja (m²)	Vlera sipas preventivit (lekë)		
1	Edar	Hasan	Qëndrai	3574	10//6	truall+ndërtesë	104	104	1015	105,560	74	1,645,255.57	1,750,815.6	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Tepelenë
2	Edar	Hasan	Qëndrai	3574	10//206	truall+ndërtesë	82	64	1015	64,960	98.6	2,531,459.68	2,596,419.7	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Tepelenë
3	Klodian	Gezim	Çunaj	3574	10//7	truall+ndërtesë	100	50	1015	50,750	100	3,741,807.49	3,792,557.5	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Tepelenë
4	Gezim		Çunaj	3574	10//11	truall+ndërtesë	810	638	1015	647,570	208	6,262,439.42	6,910,009.4	Konf. nga ZVRPP-ja. Kufizim veprimesh mbi pasurinë për parregullsi.
	Mimoza		Duma											
	Klodian		Çunaj											
	Ilirjan		Çunaj											
	Kristian		Lalo											
	Eni		Çunaj											
	Merita		Lalo											
	Ema		Lalo											
5	Ali	Zaim	Abazi	3574	10/113	truall+ndërtesë	84	1	1015	1,015	168	5,407,684.36	5,408,699.4	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Tepelenë
6	Habil	Muhamet	Goxha	3574	8//68	truall+ndërtesë	78	67	1015	68,005	52	1,172,021.90	1,240,026.9	Konf. nga ZVRPP-ja. Kufizim veprimesh mbi pasurinë për parregullsi.
7	Agim		Baca	3574	10//5	truall+ndërtesë	64	60	1015	60,900	64	1,998,772.57	2,059,672.6	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Tepelenë
8	Elidon	Levend	Malaj	3574	10/208	truall	237	141	1015	143,115			143,115	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Tepelenë
9	Hektor	Barjam	Agaraj	3574	10//2	truall	48	45	1015	45,675			45,675	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Tepelenë
	SHUMA							1170		1,187,550	764.60	22,759,440.99	23,946,990.99	

**KËRKESË****Nr. 6489/7, datë 18.12.2019****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preket nga projekti, “Rikonstruksion i rrugës ‘Dhimitër Shuteriqi’”, në Tiranë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personin e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

